



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 212/1prot

Shkodër, më 08.03.2024

Lënda: Mbi vendimin Nr.14, datë 27.02.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 datë 02.10.2016 "Për Prefektin", Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", në mbështetje të nenit 54 shkronja ç, nenit 55/2, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM Nr.328/2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" analizoi VKB Vau Dejës Nr.14, datë 27.02.2024 "Për shtesë page për kushte pune sipas pikës 4, gërma b e VKM Nr.328/2023, punonjës të TIK".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Ju lutem ky akt duhet të jetë pjesë e VKB mbi miratimin e pagave të vitit 2024.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 14 Datë 27.02.2024

PËR

“DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN E PUNONJËSVE PËR VITIN BUXHETOR 2024”

Bazuar në nenin 54, pika ç, e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës nr. 90, datë 21.12.2023, “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”, në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.1074, datë 05.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për cdo pozicion të shërbimit civil dhe administrative për vitin buxhetor 2024”, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Sektori Burimeve Njerëzore Këshilli Bashkiak:


VENDOSI:

1. T’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, Z. Denis Shkoza, i punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të IT”, niveli i diplomës “Bachelor” në degën “Inxhinieri Kompjuterike”, bazuar në pikën 4/b të Vendimit nr. 328, datë 31.5.2023.
2. T’i jepet një shtesë mbi pagë në masën 5000(pesë mijë) lekë në muaj, Z. Sabion Beqiri, i punësuar në pozicionin “Specialist i Sektorit të IT”, niveli i diplomës “Bachelor” në degën “Informatikë”, bazuar në pikën 4/b të Vendimit nr. 328, datë 31.5.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë me datë 01.01.2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Buxhetit dhe Financës.



SEKRETARI I KËSHILLIT


Ardian Çelepija



KRYETARI I KËSHILLIT


Ervis Shimaj

Miratuar me 19.....vota

Vota pro. 19...

Vota kundër.....
-

Vota abstenim.....
-

Zbardhur me datë 04.03.2024